

ARSIMI NË TETOVË E RRETHINË PAS LUFTËS SË DYTË BOTËRORE*(Themelimi i shkollave të para 1944-1959 në Tetovë dhe rrethinë)***Agron SALIHI****Abstrakti**

Arsimi në Tetovë, pas Luftës së Dytë Botërore, gjegjësisht në periudhën 1944 – 1959, u shoqërua me shumë vështirësi, pasi mungonte kadri i kualifikuar për mësimdhënie dhe kishte probleme me hapësirat e inventarin shkollor. Në këtë qark kohor shkalla e analfabetizmit ishte skajshmërisht e lartë. Për këtë qëllim u organizuan kurse të shpejta për mësuesi. Pati raste kur si mësimdhënës angazhoheshin persona me maturë të ulët, me ndonjë klasë të mbaruar në gjimnaz ose në ndonjë shkollë tjetër të mesme apo medrese, madje kishte mësues me vetëm katër klasë të shkollës fillore. Pas Luftës së Dytë Botërore u ndërmorën u sollën vendime dhe u ndërmorën nisma për përmirësimin e gjendjes, veçanërisht në arsimin fillor. U ndërtuan disa shkolla ku mësimi organizohej në gjuhën shqipe. Në këtë punim i kemi përshkruar në kronologji vendimet, nismat dhe zhvillimet arsimore në Tetovë e rrethinë përgjatë qarkut kohor të sipërpërmendur.

Fjalët kyçe: *Tetova, arsimi, analfabetizmi, shkollat, nxënësit...*

Komisioni për Arsimin në Maqedoni u përball me probleme të shumta pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore (LDB), sepse kishte mungesë të theksuar të kadrit mësimor, veçanërisht në vitet e para pas përfundimit të luftës.

Që të sigurohej kadri i domosdoshëm mësimor për shkollat e sapoformuara u angazhuan persona me kualifikime dhe nivele të ndryshme shkollore. Në radhë të parë u angazhuan studentët dhe maturanët në gjimnaze, madje edhe ata që e kishin kryer klasën e V, VI, VII dhe VIII të shkollës së gjimnazit (progjimnaze) apo ndonjë shkolle të mesme ose që kishin kryer vetëm semimaturën (maturën e vogël).

Situata edhe më e vështirë, për sa i përket kadrit mësimor, ishte në shkollat fillore me mësim në gjuhën shqipe dhe turke.

Si mësimdhënëse në këto shkolla u angazhuan persona me maturë të ulët, me ndonjë klasë të mbaruar në gjimnaz ose në ndonjë shkollë tjetër të mesme apo medrese, por nuk ishte i vogël numri i mësuesve me vetëm katër klasë të shkollës fillore.⁶⁵

Për fillimin dhe organizimin e mësimin në shkollat fillore, përveç mungesës së kadrit mësimor, kishte probleme edhe me mungesën e hapësirave shkollore, pajisjet, inventarin dhe mjetet tjera të domosdoshme për t'u zhvilluar procesi mësimor.

Gjatë pushtimit fashist ishin shkatërruar apo dëmtuar një numër i madh objektsh shkollorë. Maqedonia kishte trashëguar hapësira shkollore të kufizuara. Situata e vështirë me hapësirat shkollore vërtetohet me faktin se, sipas numrit të nxënësve, mbi 200 mijë të moshës 7 deri 15 vjeç, në vitin shkollor 1944 – 1945, duhej të ndiqnin shkollimin e rregullt brenda hapësirave prej vetëm 0.32 m² për nxënës.

⁶⁵ Нада Јурукова, *Културно-Просветни Појави и Процеси во Македонија (1944-1953)*, f. 53. Shkup, 2003.

Për këtë qëllim, autoritetet dhe popullata i riparuan objektet e dëmtuara shkollore dhe ndërtuan shkolla të reja, që sërish nuk mjaftonin. Në disa vendbanime shkollat punonin në hapësira të përshtatura për këtë qëllim nëpër manastire, mektebe dhe shtëpi private.⁶⁶

Në vitin 1944 në gjithë territorin e komunës së Tetovës kishte vetëm 52 shkolla me 94 mësues dhe gjithsej 5600 nxënës.⁶⁷ Kjo i shtyri autoritetet të krijonin një plan për ngritjen kulturore dhe arsimore të popullatës, në radhë të parë asaj maqedonase dhe shqiptare. Gjatë vitit 1945, në Tetovë dhe rrethinë, u hapën pesë shkolla me mësim në gjuhën shqipe, me 12 arsimtarë shqiptarë dhe me 2912 nxënës.

Procesi i hapjes së shkollave u shoqërua me vështirësi, sepse nuk kishte numër të mjaftueshëm të stafit mësimdhënës. Për këtë qëllim nxënësit shqiptarë u dërguan në kursin e mësuesisë në Shkup, që për kohë të shkurtër mundësonte krijimin e një kuadri mësimor që duhej të plotësonte nevojat e qytetit dhe të rrethinës në planin arsimor.

Në vitin 1949, në Tetovë me rrethinë, kishte 47 shkolla fillore maqedonase, shqipe dhe turke, shkolla të ulëta (progjimnaze) dhe gjimnaze, me mbi 136 mësues dhe profesorë dhe përafërsisht 7232 nxënës, që u vlerësua si një hap i madh përpara.⁶⁸

Në qytet dhe fshatrat e Tetovës iu kushtua vëmendje shkrim–leximit të shqiptarëve, sepse ishte shumë e lartë shkalla e analfabetizmit. U ndërmorën masa për regjistrimin e të gjithë fëmijëve në shkollë, të cilët duhej ta mësonin shkrim - leximin në gjuhën amtare. Nxënësve iu dha mundësia ta ndiqnin edhe arsimin e lartë, pra në gjimnaze dhe shkolla profesionale me mësim në gjuhën shqipe. Sipas statistikave, në fillim të vitit 1945, shkalla e analfabetizmit te popullata shqiptare ishte 93 %.⁶⁹

Në rajonin e komunës së Tetovës, gjatë Mbretërisë së Jugosllavisë, rrjeti shkollor ishte shumë pak i zhvilluar dhe i orientuar drejt përfshirjes së nxënësve në arsimin fillor katërvjeçar. Në këtë periudhë nuk ekzistonin shkollat shqipe. Kjo bëri që analfabetizmi të ishte shumë i lartë dhe të mbulonte mbi 60 për qind të popullsisë së përgjithshme mbi 10 vjeç. Në vitin 1944 u gjetën 52 objekte shkollore, por rrjeti shkollor përfshinte gjithsej 5600 nxënës. Pas Luftës së Dytë Botërore u ndërmorën masa për përmirësimin e kësaj gjendje.⁷⁰

Pas Luftës së Dytë Botërore, nga viti 1945, në rajonin e Komunës së Tetovës funksionuan këto shkolla për arsimin e nivelit të dytë: Gjimnazi "Kiril Pejçinoviç" dhe Shkolla Bujqësore "Moshë Pijade". Në kuadër të Gjimnazit funksiononin paralele pedagogjike. Shkolla fillore të zhvilluara në Tetovë ishin: "Lirija", "Përparimi" në fshatin Reçicë, "Skënderbeu" në Poroj, "Dielli" në Zhelinë, "Dame Gruev" në Shemshovë, "Kiril Pejçinoviç" në Tearcë, "Simçë Nastovski" në Vratnicë, "Marshall Tito" në Pirok, "Lirija" në Zherovjan, "Bratstvo" në Çellopek, "Revolucioni Popullor" në Bogovinë, "Zheden" në Grupçin, "Koço Racin" në Brvenicë, "Vllaznimi" në Dobrosht, "Goce Delçev" në Stençe si dhe shkollat fillore në Sellcë, Shipkovicë dhe Veshallë.

Faktorët arsimorë në komunë ndërmorën masa dhe nisma të reja për modernizimin e arsimit dhe përfshirjen më të madhe të fëmijëve në shkollimin e detyrueshëm tetëvjeçar. Me vendime të veçanta të komunës dhe të organizatave të punës, u inkurajua shkollimi dhe kualifikimi i vazhdueshëm nëpërmjet kreditimit dhe bursave.

⁶⁶ Ристо Кантарциев, *Историја на образованието и просветата во Македонија*, Shkup, 2002, f. 548-549.

⁶⁷ Јован Павловски, Живко Стефановски, *Тетово*, Shkup. 1969, f. 73,74.

⁶⁸ Gazeta "Шар"- "Shar", Tetovë, 1 shtator, 1949. f. 4.

⁶⁹ Ibid.

⁷⁰ Јован Павловски, Живко Стефановски, *Тетово*, Shkup. 1969, f. 126.

Kjo bëri të mundur rritjen e numrit të personave profesionistë dhe të kualifikuar dhe ndryshimin e ndjeshëm të arsimit, si dhe kualifikimit në strukturën e popullsisë.⁷¹

Sipas të dhënave, në vitin 1945 në Tetovë e rrethinë funksiononin 104 shkolla katërvjeçare dhe disa shkolla të mesme: Shkolla fillore "Marshall Tito", "Andreja Savevski-Kikish", "Lirija", "Istikball", kurse më vonë u hapën shkollat fillore, siç janë: "Bratstvo i Edinstvo", "Zufer Musiq" dhe "Kirili dhe Metodi".

Më 17 nëntor 1948, qeveria e Republikës Popullore të Maqedonisë e solli vendimin për përfshirjen e të gjithë fëmijëve në shkollimin e detyrueshëm fillor. Ministria e Arsimit dërgoi instruktorë në terren për t'i ndihmuar autoritetet vendore në mbledhjen e të dhënave. Për të pasur pasqyrë të saktë të numrit të fëmijëve që i nënshtrohen shkollimit të detyrueshëm, sipas udhëzimit të ministrisë së Arsimit, bordet ekzekutive vendore dërguan ekipe në fshatra për të bërë regjistrim. Ekipet përbëheshin kryesisht nga edukatorë dhe përfaqësues të organizatave socio-politike.⁷²

Në vitin 1949 në rrethinën e Tetovës funksiononin 74 shkolla fillore me mbi 9942 nxënës. Prej tyre 44 shkolla me 5813 nxënës ishin në gjuhën shqipe. Kështu u bë përpjekje për ngritjen e popullatës shqiptare në një nivel të denjë kulturor.⁷³

Nga fundi i vitit 1951 në rrethinën e Tetovës u hapën edhe 12 shkolla fillore, kurse numri i nxënësve u rit për 1200. Në fund të vitit 1951 çdo fshat i madh kishte shkollën e vet. Gjatë këtyre dy viteve e gjysmë, në rrethinën e Tetovës, u ndërtuan katër objekte të reja shkollore, me kushte të mira higjienike dhe me ndriçim adekuat.⁷⁴

Gjatë vitit 1951 në rrethinën e Tetovës punoni tri shkolla shtatëvjeçare me 371 nxënës, prej të cilëve 126 nxënës shqiptarë. Në fshatin Tearcë u vu në përdorim objekti modern për shkollën shtatëvjeçare.⁷⁵

Në periudhën 1952/53, në territorin e rrethit të Tetovës, funksiononin edhe dy shkolla tetëvjeçare. Në shkollën e fshatit Tearcë mësimi zhvillohej në tre gjuhë: maqedonisht, shqip dhe turqisht. Nga gjithsej 860 nxënës, 560 ishin maqedonas, 250 shqiptarë dhe 48 turq. Stafi mësimor ishte i përzier. Në paralelet në gjuhën shqipe, për shkak të mungesës së kuadrit të kualifikuar mësimor nga radhët e komunitetit shqiptar, mësimin e zhvillonin edhe arsimtarë nga nacionalitetet tjera (serb e maqedonas) dhe në gjuhën maqedonase.⁷⁶

Në fillim të vitit 1950, për nxënësit me mësim në gjuhën shqipe në Tetovë, u vu në përdorim ceremonial shkolla e sapondërtuar "Liria". Përveç klasave mësimore, në këtë shkollë u ndërtua një sallë për aktivitete kulturore dhe edukative. Në ceremoninë e hapjes së shkollës morën pjesë një numër i madh i banorëve nga Tetova dhe rrethina. Shkolla u hap nga komisionari i ministrisë së Arsimit dhe Kulturës në Këshillin Popullor Çlirimtar të qytetit, Nikolla Jovanovski. Sipas tij, shkolla do të luante rol të madh në ngritjen kulturore dhe arsimimin e edukimin e të rinjve në gjuhën e tyre amtare. Në ceremoni ishte i pranishëm edhe Rifat Vela, sekretar organizativ i Komitetit të qytetit në kuadër të Partisë Komuniste të Maqedonisë dhe Koço Kitanoski, sekretar i departamentit të agjitacion-propagandës në Komitetin e qytetit.

⁷¹ Ibid., f. 126-127.

⁷² Нада Жукова, Културно-Просветни Појави и Процеси во Македонија (1944-1953), f. 61.

⁷³ Gazeta "Шар"- "Shar", Tetovë, 29 shtator, 1949. f. 4.

⁷⁴ Ibid.

⁷⁵ Ibid.

⁷⁶ Qerim Lita, *Problemi shqiptar në RP(S) të Maqedonisë 1944-1974*, Shkup, 2018, f. 179.

Ata theksuan se prapambetjen e madhe në fushën kulturore të komunitetit shqiptar nga Tetova dhe vunë në dukje se regjimet e mëparshme shqiptarëve nuk u kishin lejuar asnjë të drejtë kombëtare dhe kulturore. Në këtë kohë qyteti kishte 1065 nxënës të shkollave fillore shqiptare dhe 341 gjimnazistë.⁷⁷

Sekretariati i Komitetit të Qarkut të Lidhja Komuniste e Maqedonisë për Tetovën, në mbledhjen e mbajtur më 8 korrik 1959, duke u bazuar në analizën "*Mbi përpjekjet e mëparshme në thellimin e barazisë kombëtare në rrethin e Tetovës*", paraqitur në mbledhjen e zgjeruar të Komitetit të rrethit të LKM, të mbajtur më 6 korrik 1959, solli disa rekomandime.

1. Rekomandohej që Këshilli për Arsim i Këshillit Popullor të Tetovës me rrethinë, së bashku me autoritetet republikane, të hetonin mundësinë e hapjes së paraleleve në gjuhën shqipe në shkollat e mesme të rrethit të Tetovës; rritjen e numrit të mësimeve në lëndën e gjuhës maqedonase në paralelet me mësim në gjuhën shqipe dhe turke; futja e lëndës së shqipes, përkatësisht të gjuhës turke, në paralelet në gjuhën maqedonase në shkollat fillore; hapjen e paraleleve mësimore në gjuhën maqedonase, shqipe dhe turke në shkollën e mesme në Tetovë, mundësisht edhe në Kolegjin Ekonomik Teknik në Gostivar.

2. Rekomandohej që Këshilli për Kulturë i Këshillit Popullor të Tetovës me rrethinë të hetonte mundësinë e instalimit të radiostacionit në Tetovë, i cili do të lidhej me Radio Shkupin; themelimin e teatrit në qytetin e Tetovës me dy seksione në gjuhën maqedonase dhe shqipe, mundësisht edhe në gjuhën turke; përveç kësaj, Këshillit për Kulturë i rekomandohej të siguronte kushte materiale për ngritjen e bibliotekave në fshatrat shqiptare, që duhej të sigurohej në bashkëpunim me këshillat popullore të bashkive.

3. Rekomandohej që Këshillat për administratë të përgjithshme dhe punë të brendshme të Këshillit Popullor të Tetovës me rrethinë ta shqyrtonin mundësinë e përdorimit më të gjerë të gjuhëve të pakicave në administrimin e këshillave popullore, institucioneve, prokurorive publike dhe gjykatave.⁷⁸

Shkollat fillore tetëvjeçare, si institucione të edukimit dhe arsimit fillor, filluan të hapeshin në Republikën e Maqedonisë nga viti 1950. Ndërkaq, shkolla fillore tetëvjeçare, si i vetmi institucion për arsimin fillor të detyrueshëm dhe edukimin e fëmijëve nga mosha 7 deri në 15 vjeç, u pranua vetëm me Ligjin e Përgjithshëm për Shkollimin nga viti 1958 dhe prej atëherë u bë një gurë themeli për gjithë sistemin arsimor në vend.

Literatura:

- [1]. Нада Јурукова, *Културно - просветни појави и процеси во Македонија* (1944-1953), Shkup, 2003.
- [2]. Ристо Кантарциев, *Историја на образованието и просветата во Македонија*, Shkup, 2002.
- [3]. Јован Павловски, Живко Стефановски, *Тетово*, Shkup, 1969.
- [4]. Qerim Lita, *Problemi shqiptar në RP(S) të Maqedonisë 1944-1974*, Shkup, 2018.
- [5]. Gazeta "Шар"- "Shar" Tetovë, 1 shtator, 1949 dhe 16 shkurt 1950.
- [6]. ДАРМ, Подрачно одделение –Тетово, кут.бр.52 . Околиски Народен Одбор Тетово –Тетово, 1944-1965година, Совет за просвета 1959-1964. Записници од одржани седници на Советот за просвета.

⁷⁷ Gazeta "Шар"- "Shar", Tetovë, 16 shkurt, 1950. f. 3.

⁷⁸ ДАРМ, Подрачно одделение –Тетово, кут.бр.52 . Околиски Народен Одбор Тетово –Тетово, 1944-1965година, Совет за просвета 1959-1964. Записници од одржани седници на Советот за просвета.